

VENDIM
Nr. 885, datë 30.10.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 692, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN DHE MARRJEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I URAVE DHE RRUGËVE
HYRËSE TË PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 692, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në tabelat 1 dhe 2 bëhen ndryshimet në numrat rendorë përkatës, sipas të dhënave të përcaktuara në tabelat 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët dhe përdoruesit e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen dhe merren në përdorim të përkohshëm, të kompensohen në vlerë të plotë për sipërfaqen 29 074.72 (njëzet e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër pikë shtatëdhjetë e dy) m², e cila shpronësohet, dhe për sipërfaqen 38 214.21 (tridhjetë e tetë mijë e dyqind e katërmëdhjetë pikë njëzet e një) m², e cila merret në përdorim të përkohshëm, me një vlerë totale kompensimi prej 21 061 715.06 (njëzet e një milionë e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë pikë zero gjashtë) lekësh, ku përfshihen vlera e shpronësimit, vlera e marrjes në përdorim të përkohshëm, vlera e kulturave bujqësore dhe vlera e objekteve, sipas të dhënave të përcaktuara në tabelat 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë, Devoll, Skrapar dhe shoqëria Trans Adriatic Pipeline (TAP AG) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama